



19 mars 2008

Z. Mahir Yagcilar
Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

CR nr. 1069/05

Lidhur me ndotjen e lumit Llap nga Kompania “Pajtimi”

I nderuari z. Yagcilar,

Në bazë të nenit 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, Institucioni i Ombudspersonit ka kompetenca për të bërë hetime, qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet. Institucioni i Ombudspersonit, në zbatim të detyrës së tij në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një rëndësi të veçantë i ka kushtuar problemeve mjedisore. Për të konkretizuar përpjekjet tona në këtë drejtim, po ju prezantojmë një çështje për të cilën jemi njohur në bazë të një artikulli të botuar në gazetën ditore “Lajm ekskluziv” më 2 gusht 2005. Artikulli në fjalë ngrinte shqetësimin për ndotjen e Lumit Llap nga ana e ujërave të shkarkuara nga Kompania “Pajtimi” (më tej “Kompania”) që gjendet në fshatin Llugë të Komunës së Podujevës, me ç’rast fshatarët ballafaqoheshin me probleme të ndryshme si rrezikimi i shëndetit të fëmijëve, pamundësia e përdorimit të ujit për ujitjen e kulturave bujqësore, ndotja e lumit në atë shkallë sa janë vërejtur edhe peshq të ngordhur etj.

Pas kësaj Institucioni i Ombudspersonit ka filluar hetimet lidhur me këtë çështje. Në kuadër të hetimeve lidhur me këtë çështje, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjatë vitit 2006-2007 ka dërguar disa letra në adresë të Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor (më tej "MMPH") dhe të Kryetarit të mëparshëm të Komunës së Podujevës (kopjet e bashkëngjitura), si dhe janë zhvilluar disa takime nga përfaqësues të Institucionit të Ombudspersonit me zyrtarë të MMPH, po ashtu është bërë edhe shikimi i gjendjes në terren. Me këtë rast janë konstatuar mjaft parregullsi sa i përket zbatimit të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Mbrojtjen e Mjedisit i shpallur më 16 Janar 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/9, (më tej "Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit"). Duke qenë se Kompania shkarkimin e ujërave dalëse teknologjike dhe hedhjen e mbeturinave yndyrore e bën në Lumin Llap pa ndonjë trajtim adekuat, si pasojë bëhet ndotja e ujit të lumit të cilin ujë fshatarët e fshatrave përreth deri me fillimin e punës së Kompanisë e përdorin për ujitjen e kulturave bujqësore. Gjithashtu, kjo ndotje e ujit të lumit rezulton edhe me rëndimin e ajrit në mënyrë të theksuar duke krijuar erëra të rënda në të gjithë ambientin përreth. Kjo çështje shkaktonte një shqetësim serioz për banorët e fshatrave përreth, meqenëse përveç që s'mund të ujin kulturat bujqësore në kopshtet e tyre, ekziston edhe rreziku për shëndetin e fëmijëve të tyre nëse vijnë në kontakt me ujin e lumit.

Problemi që ju prezantojmë ekziston prej kohësh dhe megjithatë, edhe pse Institucioni i Ombudspersonit kishte ngritur këtë çështje tek MMPH dhe Komuna e Podujevës tash e tri vite, me keqardhje konstatohet që autoritetet kompetente qëndrojnë pasive dhe nuk veprojnë në marrjen e masave për eliminimin e ndotjeve mjedisore. Duke iu referuar nenit 43 pika 1 të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit, është përcaktuar ndër të tjera se "*Inspektorati mjedisor do të jetë përgjegjës për përmbushjen e detyrave specifike të deleguara për Inspektoratin mjedisor me këtë ligj ...*". Gjithashtu, neni 78 i Ligjit Nr.2004/24 për Ujërat e Kosovës, ndër të tjera thotë: "*78.1. Mbikëqyrjen inspektuese të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij Ligji, e kryen Ministria përmes Inspektoratit të Ujërave. [...] 78.6 Detyrat e inspektorit janë: a. të urdhërojnë ndërprerjen e aktiviteteve kur kryhen në kundërshtim me lejen ujore apo kryhen pa leje ujore dhe të caktojë afatin për parashtrimin e kërkesës për dhënie e lejes ujore; [...]*".

Bazuar në hetimet tona, Kompania në fjalë i takon kategorisë së industrisë ushqimore dhe merret me përpunimin e vajrave dhe lëngjeve. Në Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ nr.9/2004 mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis janë të renditura Veprimtaritë që duhet t'i nënshtrohen procesit të plotë të VNM-së, ku në pikën (27.) tek Industria ushqimore renditen edhe "*1. Trajtimi dhe përpunimi i synuar për prodhimin e produkteve ushqimore nga: a) lëndët e para me origjinë shtazore (përveç qumështit) me kapacitet të prodhimit final më të madh se 30 tonë/ditë; b) lëndët e para bimore me kapacitet të prodhimit final më të madh se 250 tonë/ditë [...]*".

Në nenin 56 të Ligjit nr.2004/ 24 për Ujërat e Kosovës, ndër të tjera përcaktohet se leja ujore lëshohet edhe për "*b) shkarkim të ujërave të ndotura*".

Duke iu referuar Udhëzimit Administrativ nr.2/2004 mbi Themelimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, neni 7 ku parashihen përgjegjësitë e Inspektoratit, ndër të tjera thuhet se "*Në kryerjen e punëve të mbikëqyrjes inspektuese inspektori është i obliguar që të kontrollojë posaçërisht: c) Zbatimin e normave dhe standardeve të përcaktuara me aktet e nxjerra sipas Ligjit k) Zbatimin e masave dhe kushteve ligjore mbrojtëse të mjedisit jetësor dhe leja ekologjike;*"

Në bazë të informatave që posedojmë, kjo Kompani edhe më tej vazhdon aktivitetin e vet edhe pse nuk është e pajisur me Leje mjedisore dhe as me Leje ujore siç e parashikon ligji dhe për këtë arsye mendojmë se duhet të jetë objekt kontrolli i menjëhershëm.

Rasti konkret gjithashtu ngritë çështjen e shkeljes së nenit 8 të Konventës Evropiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më tej "Konventa") që mbron të drejtën e individëve për respektimin e jetës private dhe familjare. Neni 8 i Konventës thotë "1. Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korespondenca e tij; 2. Autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve."

Ashtu siç edhe është konfirmuar nga aktgjykimet e përmendura më poshtë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, obligimi i shtetit sipas nenit 8 të Konventës përfshinë gjithashtu obligimin e autoriteteve publike për të mbrojtur individët nga ndërhyrja e ndonjë pale të tretë në të drejtën e tyre në jetën private dhe familjare (shih, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, aktgjykimi i datës 19 shkurt 1998, *López Ostra kundër Spanjës*, aktgjykimi i datës 9 dhjetor 1994, *Powell dhe Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 21 shkurt 1990 dhe *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 2 tetor 2001). Kjo përfshinë obligimin e autoriteteve publike që të ndërhyjnë në mbrojtjen e të drejtave të individëve që të gëzojnë të drejtën e tyre në jetën private dhe familjare, e sidomos në rastet kur është në pyetje rrezikimi i shëndetit të tyre.

Në rastin konkret, nga faktet e prezantuara më lartë dhe bazuar në përgjigjet e marra nga MMPH dhe Komuna e Podujevës (kopjet e bashkëngjitura) mund të vlerësohet nëse autoritetet publike kanë vepruar në mënyrë të duhur apo jo. Për këtë arsye, ne vëmë në dukje përsëri faktin se MMPH dhe autoritetet komunale të Komunës së Podujevës për më tepër se tri vite kanë injoruar gjendjen në rastin konkret edhe pas ankesave të qytetarëve dhe vërejtjet e Institucionit të Ombudspersonit për të mbrojtur të drejtat e individëve sipas nenit 8 të Konventës.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura më lart, ku rezultojnë të provuara shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ne kërkojmë përmirësimin e gjendjes konform standardeve të kërkuara.


Për këtë qëllim, e në pajtim me nenin 4.1.(e),(g) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë,

REKOMANDOJMË

- të urdhërohet ndërprerja e veprimtarisë së Kompanisë "Pajtimi Kompani" përderisa kjo Kompani të plotësojë kushtet për tu pajisur me Pëlqim mjedisor dhe me Leje ujore
- të informoni Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit për veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura, në pajtim me nenin 4.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Ju lutemi që të na njoftoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi brenda 30 ditëve, në pajtim me nenin 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Me nderime,



Hilmi Jashari
Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit

kopja u dërgohet: z. Hashim Thaqi, Kryeministër i Republikës së Kosovës
z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë
z. Muhamet Aliu, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
z. Ilir Morina, Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
z. Ilaz Pireva, Kryetar i Komunës së Podujevës
z. Ismet Beqiri, Kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Republikës së Kosovës
zj. Shpresa Sheremeti, Koordinatore në Njësinë për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor